

FJALA E DEPUTETIT ERVIN SALIANJI

Zonja Kryetare, pavarësisht respektit personal, po ju them se si Kryetare e Kuvendit, në vend që të jeni garante e Kushtetutës dhe e Rregullores, jeni kryesorja në shkeljen e Kushtetutës dhe të Rregullores, duke plotësuar kërkesat e partisë. Pra, çfarë thonë këta, bëni ju. Nëse ju jepni diçka me të drejtë, sipas Kushtetutës, ka ndonjë përpëlitje nga këtu, dhe ju menjëherë reagoni. Tani po ju them dy shkelje procedurale, që ju duhej t'i kishit rivënë në vend për t'i dhënë sens parlamentarizmit, gjë që jua kam thënë edhe herën e kaluar. Ju nuk respektoni as procedurën e as afatin kohor kur përjashtoni deputetët. Është e qartë se duhet të mblidhet Sekretariati i Etikës brenda 48 orëve, ndërsa ju e mblidhni kur t'ju dojë qejfi, që të mos jemi ne në seancë.

Së dyti, ju, por edhe kolegët e Partisë Socialiste, cilido që ka pak integritet, duhet të reagojnë kur deputetët aty (nuk ka rëndësi, është statusi i deputetit) preken me dorë apo kur rrethohet hyrja e parlamentit, sikur të keni këtu thesarin e Ali Babës dhe të Dyzet Hajdutëve. Unë e kuptoj se ju këtu e shikoni si thesar, sepse nga këtu ju prodhohen ato para që paguan Edi Rama (dhjetë mijë dollarë për darkën me McGonigal). Unë e kuptoj që ju e shikoni si thesar këtë vend, se nga këtu abuzoni që prodhon para Edi Rama për t'ia dhënë McGonigal-it, 220 mijë dollarë. Unë e kuptoj se ju e shikoni si thesar, se nga këtu paguan Edi Rama dhe i buron legjitimiteti që t'u japë kompanive ruse burimet naftëmbajtëse në vend, për të goditur opozitën. Unë e kuptoj se ju bëni si të shqetësuar për zhurmën në parlament. A keni qenë ju (ja ku janë disa këtu) me bilbila e jo me bilbila, por dhe me vuvuzelat që i fushit deri në grykë? A u përjashtua njeri? Ja, këtu jeni, se ka precedentë parlamenti. Ç'është kjo, more? Njëzet e ca deputetë përjashtohen dhe trajtohen si lecka, thjesht pse i do qejfi Edi Ramës, pse Edi Rama do të zhvendosë vëmendjen dhe fokusin nga kjo çështje! Tani kam edhe një çështje tjetër shumë të rëndësishme, zonja Kryetare! Si Kryetare e Kuvendit, besoj se duhet të jepni garanci dhe të kërkonit llogari tek institucionet që nuk zbatojnë ligjin "Për statusin e deputetit". Ju, jo vetëm i keni bllokuar këtu komisionet hetimore, por as Struktura e Posaçme Antikorrupsion, SPAK-u i famshëm, nuk kthen përgjigje. Kësisoj, kërkojmë ndërhyrjen nga ana juaj, që brenda afatit kohor prej pesëmbëdhjetë ditësh, SPAK-u dhe SHISH-i të kthejnë përgjigje për pyetjet që u kam drejtuar në lidhje me çështjen "Rama-McGonigal". I keni kapur të gjitha institucionet, të cilat janë vendosur nën thundrën e Edi Ramës. As këtu, nuk ka guxim njeri të flasë.

E kuptoj, dhe u jap shumë të drejtë kolegëve që rrinë me kokën ulur. Ju ka bërë të rrinë kokulur, ju ka turpëruar, ndaj nuk keni fuqi, sepse gjithçka është në dorën e një njeriu, jeni mekanizma: ngrini dorën, ulni dorën, përjashtoni kolegë dhe nuk thoni dot asnjë fjalë. Tani, që të ketë sens parlamenti, që të kenë sens institucionet, duhet të hyjmë në procedurë normale: të pranoni kërkesat tona për komisionin hetimor. Tri komisione janë bërë, jo dy. Është komisioni për aferën e portit të Durrësit, komisioni në lidhje me rastin kur Rama u kap në shkelje për çarterin, që gënjente, po ashtu është edhe afera e McGonigal-it. Çfarë sensi ka ajo që ju kërkonit, kur në këtë parlament nuk ofrohen garancitë minimale për deputetët, por shkohet deri në konfrontim fizik? Ndërkohë, ju kërkonit të përjashtohen deputetët, që gjasme të ulen deputetët. Ju keni frikë edhe nga deputetët, imagjinoni nga populli! Ju vendosni një barrierë mes qeverisë dhe deputetëve.